

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Pogradec, më 22.02.2021

Për: Operatorin Ekonomik ofertues "ADA-CO" SHPK, me adresë sipas QKB-së "POGRADEC ZONA INDUSTRIALE", me numër NIPT: K64112603J, perfaqesuar nga administratori znj. Selvi Latifllari.

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozime" - "Punë"- "Prokurim Elektronik"

Numri i referencës së procedurës: REF-82996-12-23-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti "Sistemim i varrezave te Deshmoreve", Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 30 ditë, duke filluar nga e nesërmja e datës së nënshkrimit të kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët

Oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ADA - CO SHPK **NIPT: K64112603J**

Vlera pa TVSH: 896000 (Teteqind e nentedhjte e gjashte mijë) lekë.

2. 2N SHPK **NIPT: L31615017L**

Vlera pa TVSH: 1195580 (Nje milion e njeqind e nentedhjte e pese mije e peseqind e tetedhjte) lekë.

3. VALONA KONSTRUKSION SHPK **NIPT: K26330202E**

Vlera pa TVSH: 816900 (Teteqind e gjashtembedhjte mije e nenteqind) lekë.

4. "Vellezerit Kuka" SHPK **NIPT: J63423440Q**

Vlera pa TVSH: 1116200 (Nje milion e njeqind e gjashtembedhjte mije e dyqind) lekë.

5. JOKLEN&CO SHPK

NIPT: K84322601F

Vlera pa TVSH: 1207250 (Nje milion e dyqind e shtate mije e dyqind e pesedhete) lekë.

6. "DOKSANI - G " SHPK

NIPT: L21809501H

Vlera pa TVSH: 1254000 (Nje milion e dyqind e pesedhete e kater mije) lekë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. VALONA KONSTRUKSION SHPK

NIPT: K26330202E

2. Vellezerit Kuka" SHPK

NIPT: J63423440Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik VALONA KONSTRUKSION SHPK në SPE, rezultoi se kishte mangësi në dokumentacion, të cilat po i parashtrijmë si më poshtë:

Sipas Vertetimit të OSHEE, me numër OSHEE-2020-9779661-EP, Tiranë, dt. 07/ 12/ 2020, rezulton se O.E ka në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 07.12.2020, **pa përfshirë faturën koherente të muajit Nentor 2020.**

Ne zbatim të nenit 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", përcaktohet shprehimisht që: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Ne zbatim të detyrimeve të mesiperme, operatori ekonomik VALONA KONSTRUKSION SHPK, duhet ta kishte paguar muajin Nentor 2020, deri me date 31.12.2020.

Vertetimi i paraqitur ku përcakton "**pa përfshirë faturën koherente të muajit Nentor 2020**", **nderkohe që afati i fundit për dorezimin e ofertave ishte 05.01.2021, përben shkas për skualifikim.**

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve", operatori ekonomik VALONA KONSTRUKSION SHPK, me numër NIPT: K26330202E, skualifikohet.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "**Vellezerit Kuka**" SHPK, NIPT: J63423440Q në SPE, rezultoi se kishte mangësi në dokumentacion, të cilat po i parashtrijmë si më poshtë:

Sipas Vertetimit të OSHEE, Nr. 1311 Prot, date 25.11.2020, rezulton se O.E ka në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.11.2020, **përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2020.**

Ne zbatim të nenit 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", përcaktohet shprehimisht që: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Ne zbatim të detyrimeve të mesiperme, operatori ekonomik "**Vellezerit Kuka**" SHPK, duhet ta kishte paguar muajin Nentor 2020, deri me date 31.12.2020.

Vertetimi i paraqitur ku përcakton "**pa përfshirë faturën koherente të muajit Nentor 2020**", **nderkohe që afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte 05.01.2021, përben shkas për skualifikim.**

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve", operatori ekonomik "Vellezerit Kuka" SHPK, me numër NIPT: J63423440Q, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik ofertues "ADA-CO" SHPK, me adresë sipas QKB-së "POGRADEK ZONA INDUSTRIALE", me numër NIPT: K64112603J, perfaqesuar nga administratori znj. Selvi Latifllari, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme PA tvsh, prej 896 000 (Teteqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ndermarrjes së Mirembajtjes së Infrastrukturave dhe Puneve Publike, Kati IV, Bashkia Pogradec*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në

dokumentat e tenderit, brenda 5 (Pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi në buletin e APP-së.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të ndiqen procedurat siç parashikohet në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.02.2021.

Ankesa: JO

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]
ENTON BERBERI**